

Shpjegimi i

Zalës së Teuhidit

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ

Shejkh Rabi' Ibën Hadij el-Medkhalij





Shpjegimi i Fjalës së Teuhidit

Lavdet janë vetëm për Allahun. Atë e lëvdojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. I kërkojmë mbrojtje Allahut prej të këqijave të punëve dhe veteve tona. Atë që e udhëzon Allahu s'ka kush ta humbë dhe atë që humb Allahu s'ka kush ta udhëzojë pos Tij. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut një të vetëm e të pashok, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob i Dërguari i Tij.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ ۖ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ ﴿١٢﴾

"O ju që besuat, frikësojuni Allahut me frikë të vërtetë dhe mos vdisni, vetëm se duke qenë muslimanë."¹

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ ۖ وَالْأَرْحَامَ ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا ﴿١﴾

"O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra. Dhe kini frikë Allahun që me Emrin e Tij përbetoheni dhe kërkon të drjetat tuaja, ruajeni farefisin, vërtetë Allahu është Mbikëqyrës mbi ju."²

¹ Ali-Imran, 102.

² En-Nisaa, 1.

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا ﴿٧٠﴾ يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ
ذُنُوبَكُمْ ۗ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا ﴿٧١﴾

"O ju besimtarë, kini frikë Allahun dhe thuani fjalë të drejta. Ai jua përmirëson veprat tuaja, jua falë mëkatet tuaja, e kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ai padyshim ka arritur një fitore të madhe."³

E më pas:

S'ka dyshim se fjala më e vërtetë është Fjala e Allahut dhe udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – gjërat më të këqija janë ato të shpikurat dhe çdo e shpikur është bidat, dhe çdo bidat është humbje e çdo humbje është në Zjarr.

Vërtetë kapja pas Kur'anit dhe Sunetit në Akijde (besim) dhe në menhexh (metodologji) është e domosdoshme për çdo Musliman. Pra, është detyrë për ne që të kapemi për Librin e Allahut dhe Sunetin e të Dërguarit të Allahut – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* –, ky Sunet në të cilin iu dha të Dërguarit të Allahut – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* –, *Xheuamiu'l-Kelim* (Fjalë të pakta me kuptim gjithëpërfshirës).

Dhe prej fjalëve gjithëpërfshirëse të Dërguarit – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* –, e cila e përfshinë të gjithë fenë është hadithi i njohur i Xhibrilit sikurse transmeton prijësi i drejtë Umer ibnul Khatabi - *Allahu qoftë i kënaqur prej tij* - thotë:

“Ndërsa ishim tek i Dërguari Allahut – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* –, befaz erdhi një burrë me rroba shumë të bardha dhe me flokë shumë të zeza, nuk vëreheshin tek ai gjurmë udhëtimi, dhe askush

³ El-Ahzab, 70-71.

prej nesh nuk e njihte atë, i mbështeti gjunjët mbi gjunjët e Pejgamberit, dhe i vendosi duart mbi kofshët e tij, dhe tha: “Më trego për Islamin”. I Dërguari i Allahut – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – tha: *Islami është të dëshmosh se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe që Muhamedi është i Dërguari Allahut, të falësh Namazin, të japësh Zekatin, të agjërosh Ramazanin dhe të kryesh Haxhin nëse ke mundësi për ta kryer atë.*”

(Xhibrili) tha: “Të vërtetën e the”.

Umeri tha: “U çuditëm me të, sepse e pyeste dhe ia vërtetonte”. Sepse prej zakonit të paditurit është që nëse pyet për gjëra që nuk i di nuk i thotë atij që përgjigjet: “The të vërtetën”. Porse (fjalën) “Të vërtetën e the” e thotë vetëm ai që e di përgjigjen.

“Dhe u çuditëm me të, sepse e pyeste dhe ia vërtetonte” (Xhibrili) tha: “Më trego për Imanin”. (I Dërguari) tha: “*Imani është: Të besosh Allahun, Engjëjt e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij, Ditën e Fundit, dhe në Caktimin e Allahut qoftë e mirë apo e keqe.*”

(Xhibrili) tha: “Më trego për Ihsanin”! I Dërguari tha: “*Ihsani është: Ta adhurosh Allahun sikurse ti e sheh Atë, edhe nëse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty.*”

(Xhibrili) tha: “Më trego për Ditën e Fundit! I Dërguari tha: “*I pyeturi nuk di më shumë se pyetësi.*”

(Xhibrili) tha: “Më trego për shenjat e saj”! I Dërguari tha: “*Kur robëresha të lindi padronen e saj, dhe kur t'i shohësh barinjtë e varfër, këmbë zëbathur e lakuriq, duke u mburrur me ndërtesat e larta.*”

Pastaj (Pejgamberi) ndejti një kohë të gjatë dhe tha: “A e dini se kush ishte pyetësi?” Thamë: Allahu dhe i Dërguari Tij e dinë më së miri. (Pejgamberi) tha: “Ai ishte Xhibrili, erdhi që t’ju mësojë fenë tuaj.”⁴

Xhibrili erdhi në këtë formë të çuditshme, të cilën e rrëfeu Umeri – *radij-Allahu ‘anhu* – me urdhërin e Allahut, sepse Allahu i Madhëruar thotë:

وَمَا نَنْزِلُ إِلَّا بِأَمْرِ رَبِّكَ

"Ne nuk zbresim, vetëm se me urdhrin e Zotit tënd".⁵

Dhe Xhibrili – *'alejhis-selam* – nuk vjen veçse me urdhërin e Allahut. Kur një ditë (Xhibrili) nuk erdhi te i Dërguari – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – ai e pyeti Xhibrilin për këtë (vonesën), atëherë Allahu i Madhëruar zbriti (ajetin):

وَمَا نَنْزِلُ إِلَّا بِأَمْرِ رَبِّكَ لَهُ مَا بَيْنَ أَيْدِينَا وَمَا خَلْفَنَا وَمَا بَيْنَ ذَلِكَ وَمَا كَانَ رَبُّكَ

نَسِيًّا ﴿٦٤﴾

Ne (engjëjt, thotë Xhibrili) nuk zbresim (nuk vijmë) vetëm me urdhrin e Zotit tënd. Vetëm Atij i takon e tërë çështja e tashme, e ardhme dhe mes tyre (mes dy fryerjeve të Surit), e Zoti yt nuk është që harron.”⁶

I Dërguari – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – tha: "Erdhi që t’ju mësojë fenë tuaj". Sepse këto pyetje madhështore përfshijnë shtyllat e Islamit, shtyllat e Imanit si dhe gradën e tretë, atë të Ihsanit.

⁴ Transmeton Ahmedi (1/51-52) dhe Muslimi në librin e Besimit, kapitulli: Sqarimi i Besimit, Islamit dhe Ihsanit, me nr. (8).

⁵ El-Merjem, 64.

⁶ El-Merjem, 64.

Tekstet e Kuranit dhe Sunnetit përqendrohen te këto baza, edhe pse shtojnë ndonjë shtojcë në Akide, mardhënie, etj.

(Pejgamberi) përmendi shtyllat e Besimit dhe shtyllat e Islamit të cilat duhen patjetër. Këto duhet të gjenden me doemos te muslimani, sepse nëse ai humbet njëren prej tyre duke mos e besuar atë, atëherë ai nuk është as musliman as besimtar.

Ai caktoi për Islamin pesë shtylla, sikurse qëndron në hadithin e Abdullah Ibën Umerit - *Allahu qoftë i kënaqur prej tyre -* :“ Islami është ndërtuar mbi pesë (shtylla): Dëshmia se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe që Muhamedi është i Dërguari Allahut, falja e Namazit, dhënia e Zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe Haxhi për atë që ka mundësi.”⁷ Pra, këto janë shtyllat e Islamit.

“Dëshmia se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut”: Kjo është baza e fesë, dhe nuk hyn njeriu në Islam vetëm se me këtë dëshmi, e nëse ai vjen me diçka që e anullon këtë dëshmi, atëherë ai del prej Islamit.

Kuptimi i saj është: Nuk ka të Adhuruar me të drejtë përveç Allahut, thua: “Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut” d.m.th ti dëshmon se Allahu i Vetëm është Ai që e meriton adhurimin, dhe adhurimi i dikujt a diçkaje përveç Allahut është i kotë: Pejgamberët, Melaiket, njerëzit e mirë, pemët, gurët, dielli, hëna, të gjitha këto adhurohen në vend të Allahut, porse adhurimi ndaj tyre është i pavlerë.

Pra, besimtari dëshmon se vetëm Allahu është Ai që e meriton adhurimin, dhe askush nuk është ortak me Allahun në adhurim, as

⁷ Transmeton Ahmedi (2/120) dhe Bukhariu në librin e imanit, kapitulli: "Lutja juaj është imani juaj", nr. (8), dhe Muslimi në librin e imanit kapitulli: "Sqarimi i shtyllave të Islamit dhe i bazave të tij madhështore" me nr. (16)

edhe sa një grimcë. E nëse ti ja kushton diçka prej adhurimit, i cili është detyrë të jetë i sinqertë vetëm për Allahun, e që duhet kushtuar vetëm Atij, dhe vetëm Allahu duhet synuar me këtë adhurim, dhe nëse ti ia dedikon diçka prej këtij adhurimi dikujt tjetër përveç Allahut, atëherë ti i ke bërë shok Allahut – *Allahu na ruajtë* –.

Pra, është detyrë që të dijmë kuptimin e adhurimit dhe të dimë kuptimin e fjalës "*La ilahe il-lAllah*".

Vërtetë që shumica e njerëzve nuk e dinë kuptimin e adhurimit, dhe nuk e dinë kuptimin e kësaj fjale "*La ilahe il-lAllah*", thonë që kuptimi i saj është: nuk ka Krijues, Furnizues, nuk ka Kush jep jetë dhe vdekje, kush sjell dobi dhe dëm përveç Allahut...etj.

Kjo është fjalë e vërtetë, porse nuk është ky kuptimi i fjalës "*La ilahe il-lAllah*", sepse kjo fjalë që thonë ata nuk është gjë tjetër veçse besimi i Teuhidit Rrububijeh, të cilin e besuan edhe Kurejshët dhe popujt që u paraprijtën atyre duke i përgënjeshtruar të Dërguarit.

Ata besonin se Allahu është Zoti qiellit dhe i tokës, dhe se Ai është Krijuesi i kësaj gjithësie, Sistemuesi dhe Organizuesi i saj, porse ata nuk pranonin që Allahu i Vetëm është Ai që e meriton adhurimin.

Prej argumenteve që vërtetojnë dallimin midis Teuhidit Rrububijeh dhe Teuhidit Uluhijeh – të dyja janë të vërteta pasha Allahun – është se Rrububija ka kuptim të veçantë dhe cilësi të veçanta dhe se Uluhija ka kuptim të veçantë dhe të dyja këto duhen me doemos.

Pra, kafirat bënë dallim ndërmjet Teuhidit Rrububijeh dhe Teuhidit Uluhijeh, ata e pranonin Teuhidin Rrububijeh sikurse thotë Allahu – *SubhaneHu ue Te'ala* –:

وَلَيْنَ سَأَلْتَهُمْ مَنْ نَزَّلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَحْيَا بِهِ الْأَرْضَ مِنْ بَعْدِ مَوْتِهَا لِيَقُولَنَّ اللَّهُ قُلِ الْحَمْدُ لِلَّهِ بَلْ أَكْثَرُهُمْ لَا يَعْقِلُونَ ﴿١٣﴾

"Dhe nëse ti i pyet ata: "Kush e lëshon shiun nga qielli dhe me të e ngjall tokën pas vdekjes së saj?" Ata pa dyshim do të thonë: "Allahu!" Thuaj: "Të gjitha lavditë i takojnë Allahut, por shumica e tyre nuk logjikojnë".⁸

Ata nuk kundërshtojnë këtë.

Ka ardhur në ajete të shumta në sure (kaptina) të ndryshme të Kur'anit që ata besonin në Teuhidin Rrububijeh, porse ata nuk besonin në Teuhidin Uluhijeh. Allahu i Madhëruar thotë duke na treguar për gjendjen dhe realitetin e tyre:

إِنَّهُمْ كَانُوا إِذَا قِيلَ لَهُمْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ يَسْتَكْبِرُونَ ﴿٢٥﴾

"Kur u thuhej atyre: "Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut", ata e mbanin veten lart.⁹

أَجْعَلِ الْأَلْهَةَ إِلَهًا وَاحِدًا ۖ إِنَّ هَذَا لَشَيْءٌ عَجَابٌ ﴿٢٥﴾

"A i bëri ai të adhuruarit Një të adhuruar të vetëm? Vërtet, kjo është gjë shumë e çuditshme."¹⁰

وَأَنْطَلِقَ الْأَمَلَاءُ مِنْهُمْ أَنْ أَمْشُوا وَأَصْبِرُوا عَلَىٰ آلِهِتِكُمْ ۖ إِنَّ هَذَا لَشَيْءٌ يُرَادُ ﴿٢٥﴾

⁸ El-'Ankebut, 63

⁹ Es-Saffat, 35.

¹⁰ Es-Sad, 5.

"Paria nga mesi i tyre shkoi duke i thënë njëri-tjetrit: Vazhdoni të jeni të qëndrueshëm në adhurimin e të adhuruarve tuaj, vërtetë kjo është një gjë e kurdisur." ¹¹

D.m.th çështje të kurdisura kundër të adhuruarve tanë, pra ata në adhurimin e tyre përfshinë të adhuruar të tjerë, ndërkohë që pohonin veçimin e Allahut - *SubhaneHu ue Te`ala* - në krijim dhe furnizim, porse adhurimi ishte i përbashkët sipas mendimit të tyre të devijuar!

I Dërguari vinte dhe i ftonte ata për te ky Teuhid, Teuhidin Uluhijeh dhe ata e përgënjeshtrojnë atë, dhe nuk e përgënjeshtrojnë në Teuhidin Rrububijeh. Sikurse thotë Allahu - *SubhaneHu ue Te'ala* -:

وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ فَمِنْهُمْ مَّنْ هَدَىٰ
اللَّهُ

"Vëretë dërguam në çdo popull të Dërguar që t'u thonë atyre: "Adhuroni vetëm Allahun, e largojuni idhujve (adhurimit të tyre)!" Por, pati nga ata që Allahu i udhëzoi." ¹²

Dhe besoi në këtë Teuhid, i pasoi të Dërguarit dhe iu bind atyre.

وَمِنْهُمْ مَّنْ حَقَّتْ عَلَيْهِ الضَّلَالَةُ

"Dhe pati prej tyre që e merituan devijimin." ¹³

Kështu që, e përgënjeshtroi këtë Teuhid dhe ra në humbje të thellë, bëri kufër e shirk në Allahun, dhe i përgënjeshtroi të Dërguarit e Tij.

¹¹ Es-Sad, 6.

¹² En-Nahl, 36.

¹³ En-Nahl. 36.

Qëllimi është që popujt kafirë të cilët përgënjeshtrojnë të Dërguarit, nuk e refuzojnë Teuhidin Rrububijeh, porse besojnë në Rrububijen e Allahut - *SubhaneHu ue Te`Ala* -, dhe se Ai është Krijuesi, Drejtuesi dhe Organizuesi i kësaj gjithësie. Ai i krijoi ata dhe i'u dha atyre dëgjimin, shikimin, zbriti për ta shiun prej qiellit dhe bëri që të mbijnë për ta të mbjellat. Të gjitha këto i pranonin (kafirët) dhe nuk i refuzojnë.

Te ky lloji i Teuhidit (Rrububijeh) u përqëndruan shumë prej grupeve të humbura duke mos njohur tjetër përveç tij, ndërkohë që ata e thonë dhe e thërrasin në ezane fjalën "*La ilahe il-lAllah*", e thonë atë pesë herë në ditë, porse ata nuk e dinë kuptimin e saj, dhe nuk i dinë kushtet e saj, dhe ajo që i ka devijuar ata në këtë aspekt janë njerëzit e filozofisë dhe skolastikës, kelamistët (mendimtarët, filozofët) e devijuar, për të cilët ka thënë Imam Shafiu - *Allahu e mëshiroftë* - : "Gjykimi im për kelamistët është të rrihen me *xherijd* (degë palme pa gjethe) dhe me nallane dhe të shkohet me ta vërrdallë nëpër fise dhe farefise, dhe të thuhet: Ky është shpërblimi i atij që braktisi Librin e Allahut dhe Sunetin e të Dërguarit të Allahut dhe vajti me kelamistët."¹⁴

Të gjithë Imamët e Islamit e kanë ndaluar këtë filozofi të pavlerë, pas së cilës shkuan grupet e humbura, prej khauarixhëve, rafidive, m'utezilive madje edhe esharitë me sufijetë i'u bashkangjitën atyre, dhe shkenca e filozofisë i devijoi ata, për të cilën Selefët kanë ixhma mbi ndalimin e kësaj diturie dhe devijimin e pasuesve të saj. Shafiu - *Allahu e mëshiroftë* - ka thënë për të: "Që robi ta takojë Allahun me çdo gjynah përveç shirkut, është më mirë sesa ta takojë Atë duke patur diçka prej epsheve."¹⁵ Allahu na ruajtë! Ngase kjo dije i çoi ata

¹⁴ Transmeton Begauiu në shpjegimin e sunetit, vëll. 1 f.q, (218) dhe Naser el-Makdesij në përmbledhjen e librit "*El-Huxheh 'ala Tarikil-Mehaxheh*," f.q, (475) Ebu Nuajmi në Hilije, vëll. 9, f.q (116) dhe Sujutij në "*El-Emru bil Itiba*," f.q, (83)

¹⁵ E ka transmetuar Bejhakui në (el-Itikad) f.q 158, sikurse qëndron në komentet e "*Sherhu es-Sunneh*" të Berbaharit nga Shejkh Khalid er-Rradadij f.q 121.

në humbje të thellë dhe i çoi ata në mohimin dhe asgjësimin e Emrave dhe Cilësive të Allahut. Kështu që, i mohuan dhe i asgjësuan Cilësitë e Allahut me mendimet, logjikën dhe filozofitë e tyre.

Gjithashtu, e prishën kuptimin e Teuhidit të Adhurimit, dhe i dhanë kësaj fjale "*La ilahe il-lAllah*", kuptime që nuk janë prej saj dhe që kjo fjalë nuk argumenton për ato kuptime. Gjëja e vetme për të cilën argumenton kjo fjalë është se Allahu është i Adhuruari i Cili e meriton adhurimin i Vetëm, duke mos i përshkruar Atij asnjë ortak në adhurim.

Kur'ani argumenton se të gjithë të Dërguarit kanë thirrur në kuptimin e kësaj Fjale dhe në realizimin e saj.

Allahu – *Tebareke ue Te`ala* –thotë:

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ ﴿٥١﴾

"Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit përveç se të më adhurojnë Mua."¹⁶

D.m.th që të thonë "*La ilahe il-lAllah*", ta adhurojnë Atë, të kërkojnë afrim tek Ai, me atë që Ai e meriton prej adhurimit të cilin e ligjëroi e që dha leje për të.

Pra, është detyrë që ta dimë kuptimin e fjalës "*La ilahe il-lAllah*", që do të thotë: Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, dhe gjithçka tjetër përveç Tij: të Dërguarit, Pejgamberët, Melaiket dhe njerëzit e mirë, nuk meritojnë as edhe një grimcë prej adhurimit. Përkundrazi, ata të gjithë janë robër të Allahut.

¹⁶ Edh-Dharijjat, 56.

Allahu – SubhaneHu ue Te`ala – thotë:

إِنْ كُلُّ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ إِلَّا آتَى الرَّحْمَنِ عَبْدًا ﴿٩٣﴾ لَقَدْ أَحْصَاهُمْ وَعَدَّهُمْ
عَدًّا ﴿٩٤﴾ وَكُلُّهُمْ أَتَاهُ يَوْمَ الْقِيَمَةِ فَرْدًا ﴿٩٥﴾

“Gjithçka që është në qiej e në tokë, pa dyshim se ka për t’iu paraqitur të Gjithë-Mëshirshmit si rob. Ai me diturinë e Vet ka përfshirë gjithçka, dhe e ka numëruar çdo gjë të tyre në mënyrë të saktësishme. Dhe në Ditën e Kijametit që të gjithë do t’i paraqitet Atij të vetmuar.”¹⁷

Të gjithë ata (të Dërguarit) ftojnë për adhurim të singertë ndaj Allahut – ‘Azze ue Xhel-le –, ata janë adhuruesit më të mëdhenj, Pejgamberët janë zotërinjtë e adhuruesve dhe udhëheqësit e tyre, ata i frikësohen Allahut me një frikë te vërtetë, falen dhe agjërojnë për Të, japin zekatin, nënshtrohen, përulen, frikësohen dhe dridhen nga frika prej Allahut – ‘Azze ue Xhel-le –, turpërohen prej Allahut – ‘Azze ue Xhel-le –, mbështeten në Allahun – ‘Azze ue Xhel-le –, mbështeten tek Allahu për të gjitha çështjet dhe problemet e tyre.

Dhe e dinin se nuk ka ndihmë dhe fuqi për ta përveç se me (fuqinë) e Allahut – ‘Azze ue Xhel-le –, dhe ata besonin se nuk posedonin për vetet e tyre as dëm e as dobi, as jetë as vdekje as ringjallje, e as nuk posedonin për të tjerët diçka prej këtyre gjërave.

Me të vërtetë Allahu ka thënë për më të mirin dhe më të nderuarin e tyre, e ai është Muhamedi – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* –, vula e tyre:

¹⁷ Merjem, 93-95.

قُلْ لَا أَمْلِكُ لِنَفْسِي نَفْعًا وَلَا ضَرًّا إِلَّا مَا شَاءَ اللَّهُ وَلَوْ كُنْتُ أَعْلَمُ الْغَيْبَ لَا سَتَكُنْتُ مِنَ الْخَيْرِ وَمَا مَسْنِيَ السُّوءُ إِنْ أَنَا إِلَّا نَذِيرٌ وَبَشِيرٌ لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿١٨﴾

“Thuaj: Unë nuk posedoj për veten time as ndonjë dobi, as ndonjë dëm, përveç asaj që do Allahu. Sikur ta dija të fshehtë, do t’i shumoja për vete mirësitë, e nuk do të më prekte gjë e keqe. Unë nuk jam tjetër vetëm se paralajmërues dhe përgëzues për njerëzit që besojnë.”¹⁸

Allahu e urdhëron të Dërguarin e Tij që ta thotë këtë, ta thotë duke e besuar dhe duke thirrur në të – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem* –, me vërtetësi, me iman dhe me sinqeritet. Allahu – *SubhaneHu ue Te`ala* – e urdhëroi që të thotë:

قُلْ إِنِّي لَا أَمْلِكُ لَكُمْ ضَرًّا وَلَا رَشَدًا ﴿٢١﴾

“Thuaj: Unë nuk posedoj për juve ndonjë dëm e as ndonjë udhëzim!”¹⁹

Nëse kjo është gjendja e të Dërguarit të Allahut – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem* –, krijesa më e mirë e Allahut, më i afërti tek Ai, nuk posedon për të tjerët dobi ose dëm, atëherë si është puna me të tjerët përveç tij dhe me ata që janë nën të?!

Kur Allahu i shpalli atij:

وَأَنْذِرْ عَشِيرَتَكَ الْأَقْرَبِينَ ﴿٢٤﴾

“Dhe tërhiqju vërejtjen fafesisit tënd më të afërt.”²⁰

¹⁸ El-E'araf, 188.

¹⁹ El-Xhin, 21

Ai u ngjit në Safa dhe tha: "O bijt e filanit! O bijt e filanit! O bijt e Abdul Mutalib! O bijt e Fehrit! O bijt e Luej!" Ata u mbloodhën mënjeherë, dhe ai u tha: "Unë ju tërheq vërejtjen juve nga një dënim i ashpër, çka mendoni nëse unë do ju thoja se kalorësit janë mbrapa këtij mali, a do të më besonit?" Thanë: Asnjëherë nuk kemi parë që ti të gënjesh. Tha: "Atëherë unë ju tërheq vërejtjen nga një dënim i ashpër!"²¹ Atëherë Ebu Lehebi – *Allahu e poshtëroftë* – u nxeh dhe e ofendoi të Dërguarin e Allahut, duke thënë: T'u thafshin duart! A për këtë na thirre?!

I Dërguari i Allahut – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – i thirri në adhurimin e Allahut të Vetëm dhe që ta braktisnin adhurimin e Latit, Uzzait, dhe atë të tretin të fundit Menatin dhe të ngjashme me to prej të adhuruarve. Ndërsa Ebu Lehebi ishte në krye të udhëheqsave që e kundërshtonin dhe që e pergënjeshtonin të Dërguarin e Allahut – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* –. Ai (Ebu Lehebi) e mundoi të Dërguarin e Allahut me mundime të mëdha për shkak të këtij Teuhidi.

Sikur ai (i Dërguari Allahut) t'u thoshte atyre: Kush është Zoti juaj? Kush ju ka krijuar juve? Do të thoshin: Allahu, dhe i pari do ishte Ebu Lehebi. Kush i krijoj Qiejt? Kush e krijoi tokën? Do të thoshin: Allahu, nuk ishin kokëfortë në këtë asesi, porse kur u thuhej atyre të thonë "*La ilahe ill-Allah*", ata ishin kryeneçë.

Pra, skolastikët sollën kuptime të prishura për fjalën "*La ilahe ill-Allah*", devijuan popuj nga kuptimi i fjalës "*La ilahe ill-Allah*", dhe

²⁰ Esh-Shu'araa, 214.

²¹ Mutefekun alejhi, e ka nxjerr Bukhariu në librin e tefsirit, kapitulli: "**Dhe tërhiqju vërejtjen farefisit tënd më të afërt**" me nr: (4770). Dhe Muslimi në Librin e Imanit, kapitulli: Fjala e Allahut të Madhëruar: "**Dhe tërhiqju vërejtjen farefisit tënd më të afërt**" me nr: (208).

deri tani kanë devijuar të gjitha sektet përveç pasuesve të Menhexhit Selefij dhe Allahu e di më së miri.

Nuk e di! Ndoshta disa individë janë të një mëndjeje me ta, përndryshe metodologjitë dhe shkollat, shkollat e Sufijve dhe Rafidijve ecin me këtë komentim të pavërtetë, dhe si rrjedhojë sheh adhurimin e varreve, dhe lidhjen me dikë tjetër përveç Allahut si dhe të besuarit se njerëzit e mirë e dijnë të fshehtë dhe veprojnë në gjithësi, derisa ranë në shirk në Teuhidin Rububijeh për shkak të injorancës së tyre për kuptimin e fjalës "*La ilahe il-lAllah*", dhe për shkak të injorancës së disave prej tyre, madje edhe në kuptimet e Rububijes, çështje të cilën e dinin edhe pabesimtarët. (E gjithë kjo ndodhi) sepse në radhët e këtyre grupeve të Rafidijve dhe Sufijve, u infiltruan ateistët dhe zindikët të cilët duan ta shkatërrojnë Islamin.

Kështu që, ky ateist dhe zindik vesh tesha Islame të asketëve dhe adhuresve të mëdhenj, e në të njëjtën kohë ai është ateist, i cili mbjell shirkun, ateizmin, *hululin* (mishërimi i Krijuesit me krijesat), si dhe *uahdetul-uxhudin* (panteizëm), të gjitha këto gjëra janë të përhapura në grupacionet e sufijve. Madje, në përgjithësi nuk mendoj se gjendet ndonjë grup sufistësh mbi sipërfaqen e tokës përveç se bien në shirk, hulul dhe në *uahdetul-uxhud*. Ndoshta shpëtojnë disa njerëz prej rënies në ateizëm, porse kokat e këtyre grupeve sipas asaj që mendoj unë, nuk shpëtojnë nga ky devijim dhe nga besimi se njerëzit e mirë e dijnë të fshehtë dhe veprojnë në gjithësi. Gjithashtu, ata nuk shpëtojnë nga akideja e *hululit*, *uahdetul-uxhudit*, lutja e dikujt tjetër përveç Allahut, therja për dikë tjetër përveç Allahut dhe kërkimi i ndihmës nga dikush tjetër përveç Allahut.

Prej Allahut kërkojmë mirëqenie.

Kështu që, ne e kemi obligim që ta dijmë kuptimin e fjalës "*La ilahe il-lAllah*", me njohje të qartë dhe të dukshme, si dhe ta dijmë

kuptimin e ibadetit të cilin e përmban fjala "*La ilahe illAllahu*". Sikurse thotë Shejkhul-Islam Ibën Tejmijeh: "Adhurimi është një emër gjithëpërfshirës për çdo gjë që e do Allahu dhe kënaqet me të, prej fjalëve dhe punëve të dukshme dhe të fshehta." Adhurimi përfshin adhurimin e zemrës, gjuhës dhe të gjymtyrëve.

Adhurimet e zemrës janë: Frika (khauf), shpresa (rraxha), dëshira (rragbeh), frika e tmershme nga dënimi i Allahut (rrahbeh), mbështetja në Allahun (teuekul), dashuria (mehhabeh), e të ngjashme më këto nga çështjet e zemrës. Këto janë adhurimet e zemrës të cilat janë të patjetërsueshme dhe nuk lejohet që t'ia dedikojmë diçka prej këtyre adhurimeve dikujt tjetër përveç Allahut.

Adhurimet e gjuhës: Në krye të këtyre adhurimeve qëndron shprehja e Dy Shehadeteve, pastaj lutjet e tjera, siç është këndimi i Kur'anit, detyrimet (*uaxhibatet*) dhe veprat e pëlqyera (*sunnetet*). Pra, e shprehura me gjuhë në namaz është detyrë, duke lexuar Fatihanë në çdo rekat. Sikurse ka thënë i Dërguari Allahut – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* –:

لا صَلَاةَ لِمَنْ لَمْ يَقْرَأْ بِفَاتِحَةِ الْكِتَابِ

"Nuk ka namaz për atë që nuk lexon Fatihanë."²²

Pra, këto janë prej çështjeve të cilat janë detyrë për çdo musliman që t'i zbatojë ato dhe të flasi me to, e prej tyre ka gjëra të pëlqyeshme, si për shembull: Leximi i Kur'anit, përkujtimi i Allahut të thënit *subhanAllah, elhamdulilah*, pas namazeve, kur fle, kur udhëton, kur nuk je udhëtar e të ngjashme me to. Kështu që adhurimet ndahen në të obliguara dhe të preferuara. Andaj, është detyrë mbi çdo

²² *Mutefekun alejhi*, transmetohet nga Bukhariu në Librin e Ezanit, kapitulli: Obligueshmëria e leximit për imamin dhe për xhematin në të gjitha namazet, me nr: (756); dhe nga Muslimi në Librin e Imanit, kapitulli: Obligueshmëria e leximit të Fatihës në çdo rekat, me numër: (394).

musliman që t'i dijë dhe të afrohet me to tek Allahu - 'Azze ue Xhel-le -.

Adhurimet e gjymtyrëve: Në krye të tyre vjen qëndrimi në këmbë në namaz, rukuja (përulja), sexhdeja, veprat e haxhit, tauafi (rrotullimi rreth Qabes), ritualet dhe simbolet e Haxhit, si dhe adhurime të tjera nga adhurimet e gjymtyrëve. Falesh për Allahun me gjymtyrët, zemrën dhe gjuhën tënde, bie në ruku, bie në sexhde, ngrihesh prej rukusë, ulësh midis dy sexhdeve, udhëton me trupin tënd në Haxh për ta kryer këtë shtyllë (të Islamit), bën tauaf, pastaj përshkon Saffan dhe Mer'uan, i kryen ritualet e Arafatit, etj.

Këto janë adhurime që ushtrohen me trup, duke shtuar se ti ke nevojë për pasuri që t'i realizosh këto adhurime.

Adhurimet nga ky këndvështrim janë të shumta, si adhurimet e zemrës, adhurimet e gjuhës, adhurimet e gjymtyrëve, është obligim që t'i kryejmë ato me sinqeritet për Allahun. Sinqertiteti është i domosdoshëm në çdo adhurim me të cilin afrohemi tek Allahu - 'Azze ue Xhel-le -. Kërkojmë prej Allahut - 'Azze ue Xhel-le - që të na frymëzojë neve dhe juve me udhëzim, të na japi sukses dhe të na furnizojë me fik'h (kuptim) në fenë e Tij. Veçanërisht, në çështjen e fesë (besimit) së Allahut - 'Azze ue Xhel-le -, sepse fik'hu në akideh quhet fik'hu më i madh (*el-fik`hul-ekber*), kurse fik'hu në dispozita quhet fik'hu i vogël (*el-fik`hul-asgar*).

Ndërsa, fik'hu i vogël me të gjitha kategoritë e tij ndërtohet mbi fik'hun e madh, i cili është Akideja.

Kërkojmë prej Allahut që të na japi sukses neve dhe juve në fenë e Tij. Lëvdata dhe bekimi i Allahut qoftë mbi Pejgamberin tonë Muhamedin, mbi familjen dhe shokët tij.

Përktheu: Muhamed Kallashi

Pyetje - Përgjigje

Pyetja e parë: Cili është mendimi juaj për dikë që pretendon se e folura rreth Teuhidit dhe Akijdes përçan Muslimanët?

Përgjigje: Këtë fjalë e thonë grupacionet e njohura që janë bërë ekspertë në politikë dhe e lanë pas dore themelin e Islamit dhe Imanit, që është Akideja, me të cilën erdhën të gjithë Pejgamberët – 'alejhimus-salatu ues-salam –, dhe s'ka dyshim që thirrja në Teuhid bën përçarje. Bën përçarje mes kujt? Mes njerëzve të Hakut (të vërtetës) dhe njerëzve të Batilit (të pavërtetës), mes njerëzve të Teuhidit dhe njerëzve të Shirkut, sikurse ka thënë Ai – *SubhaneHu ue Te'ala* –:

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا إِلَىٰ ثَمُودَ أَخَاهُمْ صَالِحًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ فَإِذَا هُمْ فَرِيقَانِ تَخْتَصِمُونَ

"Dhe me të vërtetë Ne i dërguam Themudit vëllain e tyre, Salihun, dhe ai u tha: "Adhuroni Allahun të vetëm!" Ndërsa ata u përçanë në dy grupe, që grindeshin mes veti."²³

Kur erdhi Salihu tek populli i tij dhe i thirri ata për tek Allahu – 'Azze ue Xhel-le – ata u ndanë në dy grupe që grindeshin mes veti. Po kështu u nda edhe populli i Nuhut, siç ka thënë Ai – *SubhaneHu ue Te'ala* –:

حَتَّىٰ إِذَا جَاءَ أَمْرُنَا وَفَارَ التَّنُّورُ قُلْنَا احْمِلْ فِيهَا مِن كُلِّ زَوْجَيْنِ اثْنَيْنِ وَأَهْلَكَ

²³ En-Neml, 45.

إِلَّا مَنْ سَبَقَ عَلَيْهِ الْقَوْلُ وَمَنْ آمَنَ وَمَا آمَنَ مَعَهُ إِلَّا قَلِيلٌ ﴿٤٠﴾

"E kur erdhi urdhëri (caktimi për zbritjen e dënimit mbi ta) Ynë e uji nisi të gufojë nga furra, Ne i thamë: "Ngarko në anije nga çdo lloj gjallese nga një çift, familjen tënde dhe ata që besuan, përveç atyre që nuk besuan!" Por shumë të paktë ishin ata që i kishin besuar atij!"²⁴

Kurse pjesa tjetër u ndanë, e braktisën atë dhe ndoqën Shejtanin.

Po ashtu, edhe Ibrahimin – 'alejhis-selam – e kundërshtoi populli i tij dhe nuk besoi askush me të, në vendin e tij të origjinës, me përjashtim të gruas së tij, Sara, si dhe djali i vëllait të tij, Luti. Dhe pas një kohe të gjatë, ai i'u lut Allahut – 'Azze ue Xhel-le – në fundin e jetës së tij dhe Ai i dhuroi Ismailin dhe Is`hakun.

Nuk ka patur peygamber që të mos jenë përçarë njerëzit për shkakun e tij, ngase jo të gjithë njerëzit e ndjekin atë, sikurse ka thënë Allahu – SubhaneHu ue Te'ala –:

وَمَا أَكْثَرُ النَّاسِ وَلَوْ حَرَصْتَ بِمُؤْمِنِينَ ﴿١٣﴾

"Shumica e njerëzve, sado që të përpiqesh ti (për udhëzimin e tyre), nuk janë besimtarë."²⁵

Kështu që, sipas politikës së atyre (që thonë se e folura rreth Akijdes përçan Muslimanët), i bie që Nuhu, Ibrahimin dhe Pejgamberët e tjerë paskan gabuar! Përse? Sepse ata përçanë umetin! Ata duhet të ruanin unitetin e umetit, unitetin e atdheut dhe unitetin e patriotizmit! A nuk i bie që të jetë kështu, sipas logjikës së tyre?! Aq sa i shikon ata të vëllazërohen me të Krishterët, me Çifutët, me Rrafidat dhe Batinijet, që të ruajnë unitetin njerëzor. Ata nuk

²⁴ Hud, 40.

²⁵ Jusuf, 103.

përballen me Çifutët, me të Krishterët dhe me vëllezërit e tyre, Rrafidat. Ky është realiteti i tyre dhe kjo është thirrja e atyre që e thonë këtë fjalë. Dhe kjo fjalë bie ndesh me të gjitha shpalljet dhe me të gjitha thirrjet e të gjithë të Dërguarve, prej të cilëve është edhe Vula e tyre, Muhamedi – *sal-lAllahu 'alejhi ue sellem* –.

Allahu e quajti Kur'anin "*Furkan*" (ndarës, përçarës), ngase ai bën ndarje mes Hakut dhe Batilit. Edhe Muhamedi është ndarës ose bëri ndarje mes njerëzve, bëri ndarje mes njerëzve të Hakut, Udhëzimit dhe Imanit dhe njerëzve të Kufrit, gënjeshtres, poshtërsisë, Shirkut dhe devijimit. E domosdo që Allahu – *SubhaneHu ue Te'ala* – do t'i ndajë ata Ditën e Kijametit në dy grupe: njëri grup në Xhenet dhe grupi tjetër në Zjarr.

Kështu pra, ata janë njerëz të devijimit dhe njerëz të epsheve. Kush i shan Sahabët s'ka problem! Kush i bën qafir (Sahabët) s'ka problem! Përse? Për të ruajtur unitetin! Ka të ngjarë që ndonjëri prej tyre e dëgjon të Krishterin duke sharë Islamin dhe të Dërguarin – *sal-lAllahu 'alejhi ue sellem* – dhe hesht! Ata janë vëllezërit e tyre! Kjo është rrugë e devijuar. Ne duhet ta njohim Menhexhin e Pejgamberëve – *'alejhimus-salatu ues-selam* – dhe të thërrasim në Teuhidin e Allahut së pari, përpara çdo gjëje tjetër, si dhe në realizimin e kuptimit të fjalës "*La ilahe il-lAllah*" dhe në realizimin e kuptimeve të tjera të Islamit, të cilat ngrihen mbi këtë fjalë dhe ngrihen mbi Imanin; si dhe duhet që të mos i përfillim të tilla interpretime deformuese të thirrjes në Allah dhe atyre që i përhapin ato, ngase edhe Pejgamberët hasën të tilla interpretime e mos më keq, prandaj ka thënë i Dërguari i Allahut – *sal-lAllahu 'alejhi ue sellem* –:

أَشَدُّ النَّاسِ بَلَاءًا الْأَنْبِيَاءُ ثُمَّ الصَّالِحُونَ ثُمَّ الْأَمْثَلُ فَلَا مَثَلَ

"Njerëzit që janë sprovuar më së shumti janë Pejgamberët, pastaj njerëzit e devotshëm, pastaj ata që u ngjajnë atyre më së shumti, pastaj ata që u ngjajnë atyre më së shumti."²⁶

Njerëzit që janë përballur me dëmtimet më të rënda janë Pejgamberët - '*alejhimus-salatu ues-selam* - dhe ata janë shembulli jonë. Dhe kush ndjek rrugën e tyre patjetër që do të dëmtohet, ka gjasa që të vritet, ka gjasa që të dëbohen dhe ka gjasa që të burgosen... Kjo është një çështje madhështore, për të cilën jepen jetët dhe pasuritë. Mirëpo, ata që rreken për karriget e pushtetit dhe për jetën (e kësaj dynjaje) i mbledhin njerëzit rreth veteve të tyre dhe nuk u intereson atyre nëse vdes i biri, i vëllai, komshiu, shoku i tyre dhe përfundojnë në Zjarr! Edhe sikur ta shohin duke i bërë sexhde dikujt tjetër në vend të Allahut - '*Azze ue Xhel-le* - ose duke i bërë shirk Allahut, e megjithatë s'do t'ia dijë! Kjo është prej mashtrimit - *Allahu na ruajt* - dhe ata do t'i mbajnë mbi shpinë barrat e tyre dhe barrat e atyre që u shkojnë nga pas. Dhe mbi ta bien ajetet e Kur'anit, si për shembull Fjala e Allahut të Lartësuar:

إِنَّ الَّذِينَ يَكْتُمُونَ مَا أَنزَلْنَا مِنَ الْبَيِّنَاتِ وَأَهْدَىٰ مِنْ بَعْدِ مَا بَيَّنَّاهُ لِلنَّاسِ فِي الْكِتَابِ
أُولَٰئِكَ يَلْعَنُهُمُ اللَّهُ وَيَلْعَنُهُمُ اللَّعْنُونَ ﴿١٥٩﴾

"Me të vërtetë, ata që fshehin argumentet e qarta që kemi zbritur Ne dhe udhëzimin, pasi ua kemi shpjeguar njerëzve në Libër

²⁶ Hadithi është Sahih në sajë të rrugëve të tjera të transmetimit: e ka transmetuar Ahmedi në *el-Musned* (1/172), Tirmidhiu në *es-Sunen* (4/601/nr.2398), Ibën Maxheh në *es-Sunen* (4/369/nr.4023), Ibën Sa'd në *et-Tabakat* (2/209), ed-Darimij në *es-Sunen* (2/320), Ibën Hibbani në *es-Sahih* (7/160/nr.2900), Hakimi në *el-Mustedrak* (1/99), ed-Dijaa' në *el-Mukhtarah* (3/246/nr.1053), nga hadithi i Sa'd Ibën Ebij Uekkas - *radij-Allahu 'anhu* -. Hadithin e ka saktësuar Hakimi dhe Ibën Kethiri në Tefsirin e tij (3/405), si dhe Albani në *es-Silsiletu es-Sahijhah* (1/1/263/nr.143-145).

(Teurat), do të mallkohen nga Allahu dhe do të mallkohen nga të gjithë krijesat."²⁷

Dhe Fjala e Allahut – *SubhaneHu ue Te'ala* –:

لُعِنَ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ بَنِي إِسْرَءِيلَ عَلَى لِسَانِ دَاوُدَ وَعِيسَى ابْنِ مَرْيَمَ ذَلِكَ بِمَا عَصَوْا وَكَانُوا يَعْتَدُونَ ﴿٧٨﴾ كَانُوا لَا يَتَنَاهَوْنَ عَنْ مُنْكَرٍ فَعَلُوهُ لَبِئْسَ مَا كَانُوا يَفْعَلُونَ ﴿٧٩﴾

"Ata të cilët mohuan nga mesi i bijve të Israilit u mallkuan me gjuhën e Davudit dhe të Isait, të birit të Merjemes, për shkak se ishin të pabindur, shkelnin çdo kufi dhe nuk e ndalonin njëri-tjetrin të bënin vepra të këqija. Eh, sa të shëmtuara ishin veprat që bënin ata!"²⁸

Si është e mundur që i shikon njerëzit duke bërë tauaf nëpër varre, duke kërkuar ndihmë nga të tjerë në vend të Allahut dhe duke prerë kurban për të tjerë në vend të Allahut, e pastaj thua se thirrja për në Teuhid shkakton përçarje?! Ai ka rënë në shirk, kurse ti nuk ia sqaron atij fenë e vërtetë të Allahut, nuk ia sqaron atij Teuhidin e as nuk ia sqaron dallimin midis Teuhidit dhe Shirkut. Pastaj, nëse ai nuk e pranon thirrjen tënde, nuk hyn në rreshtin tënd.

Kështu pra, ata rreken që t'i mbledhin njerëzit në mënyrë që të arrijnë karriget e pushtetit. Dhe nëse i arrijnë ato, ata nuk e vënë në zbatim parullën e tyre "Gjykimi i takon vetëm Allahut". Gjykimi bëhet i tyre e jo i Allahut – *'Azze ue Xhel-le* –.

Allahu na dhëntë mirëqënie.

²⁷ El-Bekarah, 159.

²⁸ El-Ma`ideh, 78-79.

Pyetja e dytë: Nëse Esharitë dhe njerëzit e filozofisë nuk e njohin Teuhidin e Ibadetit dhe Teuhidin e shpjegojnë me Tehudin Rububijeh, a do të thotë kjo se ata nuk e bëjnë qafir atë që i dedikon diçka prej adhurimit diku tjetër në vend të Allahut?

Përgjigje: Nëse ata nuk e dinë kuptimin e Ibadetit, atëherë si mund ta shpallin qafir atë që adhuron të tjerë në vend të Allahut?! Ata thonë me fjalët e tyre se adhurimi sipas tyre është të bërit sexhde një idhulli. Të bërit sexhde një idhulli është adhurim për tjetërkënd në vend të Allahut, kurse duaja, kurhani, zotimi ... ata nuk mendojnë se këto e kundërshtojnë fjalën "*La ilahe il-lAllah*". Dhe nëse e shikon atë duke i refuzuar këto gjëra dhe thotë se ato janë shirk, atëherë kjo do të thotë se ai e ka mësuar kuptimin e fjalës "*La ilahe il-lAllah*". Mirëpo, a e njeh kështu çdo Esharij kuptimin e fjalës "*La ilahe il-lAllah*"? Si mund ta njohë kuptimin e fjalës "*La ilahe il-lAllah*", ndërkohë që ai thotë s'ka Krijues dhe Furnizues tjetër përpos Allahut?! E nëse thua s'ka të adhuruar tjetër me të drejtë përpos Allahut, se duaja është ibadet, kurhani për të tjerë në vend të Allahut është ibadet dhe është shirk (nëse bëhet për dikë tjetër), e kështu me radhë, ai të thotë: "Jo! Ti po i bën qafira Muslimanët se po thua që ky është shirk!" Pra, moskuptimi i domethënies së fjalës "*La ilahe il-lAllah*" të shpie në këtë devijim. Ky devijim gjendet sot. Lidhja me varret filloi si rezultat i këtyre shpjegimeve të prishura rreth domethënies së fjalës "*La ilahe il-lAllah*". Disa prej Esharive, sidomos mbas Xhihadit që bëri Ibën Tejmija dhe Ibën 'Abdul-Uehhabi - *rahimehumaAllah* - e dinë kuptimin e fjalës "*La ilahe il-lAllah*", mirëpo ata devijojnë bashkë me popullin e tyre dhe qëndrojnë me ta për hir të dynjasë, Allahu na ruajt. Pra, ka prej tyre që e dinë këtë ose një pjesë të saj, madje ka gjasa që e dinë se kjo është Shirk dhe e dinë se Menhexhi Selefij është thirrja e vërtetë, por prapëseprapë qëndrojnë me popullin e tyre. Këtë e kanë pohuar

shumë nga kokat e tyre, thonë se haku është me Selefijinët. Përse nuk i braktisin ata? Thonë: "Për kë t'i braktisim? Ne nuk i braktisim." Ata as që i sqarojnë njerëzit. Allahu na dhëntë mirëqënie. Nëse do të kishin qenë Esharitë, Sufitë etj., në rrugën e Muhamedit – *sal-lAllahu 'alje hi ue sel-lem* –, të Sahabëve dhe Imamëve të Islamit, në kuptimin e fjalës "*La ilahe il-lAllah*", a do t'i shikoje sot këto varre (që adhurohen në vend të Allahut), të cilat e kanë mbushur botën? Pra, kokat drejtuese të medreseve dhe universiteteve marrin pjesë nëpër festat që zhvillohen për shembull tek varri i Bedeviut dhe të tjerëve si puna e tij... tek varri i 'Abdul-Kadir (Xhejlanit). Ata marrin pjesë në festat e shirkut. Njerëz që mbajnë çallma mbi kokë dhe kanë diploma të studimeve të larta dhe as që kanë frikë fare që të marrin pjesë me injorantët dhe njerëzit e thjeshtë në këtë shirk që i bëhet Allahut – *'Azze ue Xhel-le* –.

Pyetja e tretë: Është e mirënjohur nga ju i nderuar rëndësia e Teuhidit dhe ajo që bënë për të Imamët e Davetit në këtë kohë, me në krye Imamin Muhammed Ibën 'Abdul-Uehhab – *rahimehullah* –. Mirëpo, dikush thotë se Shejkh Muhammed Ibën 'Abdul-Uehhab – *rahimehullah* – nuk bëri ndonjë gjë dhe nuk solli ndonjë gjë?

Përgjigje: Ai që e ka thënë këtë fjalë është xhahil, nuk e di çfarë thotë dhe as nuk e di jetëshkrimin e këtij njeriu dhe se çështjet kritike ishin në dorën e tij. Familja e Saudëve i bindej urdhërave të tij dhe i drejtonin çështjet e shtetit nga kjo pozitë e madhe të cilën ata e nderonin, pasi ai ishte imami i tyre, instruktori i tyre dhe mësuesi i tyre. Dhe ata e dinin se Allahu i shpëtoi ata nga devijimi nëpërmjet atij. Ata ishin njerëz me moral të lartë dhe me natyrë të pastër. Pra, çështjet kritike ishin në dorën e tij, nuk jepnin ndonjë urdhër pa urdhërin e tij dhe as nuk bënë gjë pa orientimin e tij. Ai ishte i madhi i shtetit dhe imami i tij pa pikë dyshimi. Kurse ky (që e ka nënvlerësuar rolin e Muhammed Ibën 'Abdul-Uehhabit) është

xhahil. Nuk e njeh historinë ky xhahil, nuk e njeh gjendjen e tij reale dhe nuk e njeh gjendjen reale të Familjes Saud që ishin pranë tij.

Allahu na dhëntë mirëqënie.

Pyetja e katërt: A ka ndonjë rregull që bën ndarjen midis shirkut të madh dhe shirkut të vogël, ngaqë unë kam lexuar shumë nëpër librat e Teuhidit, por kur vijnë tek përkufizimi i shirkut të vogël nuk përmendin më shumë se disa shembuj dhe nuk përmendin ndonjë rregull përmes të cilit të njihet shirku i vogël?

Përgjigje: Shembujt janë ato që ta sqarojnë: shirku i madh është ai që mohon bazën e Teuhidit, mohon dëshminë "*La ilahe illAllah*", kurse shikru i vogël është ai që mohon përsosmërinë e saj, përsosmërinë e Teuhidit. Imami Muhammed Ibën 'Abdul-Uehhab – *rahimehullah* – e filloi librin e tij "*Kitabut-Teuhid*" me këtë parim, e filloi me atë që mohon bazën e Teuhidit, pastaj e pasoi me atë që mohon përsosmërinë (e Teuhidit), siç është betimi në tjetërkënd pos Allahut, syfaqësia (*er-Rrijaa`*) e gjëra të tjera të kësaj natyre. Ky është rregulli. Siç është edhe varja e nuskave nëse nuk madhërohen ato, etj.

Pyetja e pestë: A më lejohet mua që të marr hua nga banka që punon me kamatë, që të blej shtëpi? Na jepni dobi, Allahu u shpërbleftë me të mira.

Përgjigje: Nëse je në atë gjendje që ke nevojë për bukë që të hash për të shpëtuar veten tënde nga vdekja, atëherë mos merr nga banka asgjë, lëre më pastaj për të ndërtuar shtëpi apo për të blerë makinë. Allahu të ka lejuar ty ngordhësirën dhe mishin e derrit, mishin e kafshëve që kanë ngodhur nga goditja apo nga brirët e kafshëve të tjera, t'i ka lejuar kur je në gjendje emergjente (sh.p. d.m.th. rrezikon

të vdesësh), porse nuk ta lejoj kamatën. Kamata është tejet e rrezikshme, është tejet e rrezikshme, është tejet e rrezikshme. Prandaj mos vepro me kamatë dhe bëj durim, ngase Allahu – SubhaneHu ue Te'ala – thotë:

وَمَنْ يَتَّقِ اللَّهَ تَجْعَلْ لَهُ مَخْرَجًا ۖ وَيَرْزُقْهُ مِنْ حَيْثُ لَا يَحْتَسِبُ
وَمَنْ يَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ فَهُوَ حَسْبُهُ ۚ

"Dhe kush i frikësohet Allahut, Ai do t'i japë rrugëzgjdhje (për çdo vështirësi) dhe do ta furnizojë andej nga nuk e pret. Dhe kush i mbështetet Allahut, Ai i mjafton atij."²⁹

Pra, kamata është gjynah i madh dhe çështje e rrezikshme, kurse ai që e bën të lejuar atë ka bërë kufër. E nëse ke nevojë për shtëpi, atëherë bëj durim derisa të të furnizojë Allahu, mbështetju Allahut dhe bëj shkaqet derisa Allahu të ta lehtësojë shtëpinë, ose përndryshe më mirë të vdesësh duke qenë i shpëtuar nga lufta e Allahut, sepse ai që merret me kamatë është në luftë me Allahun – Allahu na ruajt –, sikurse ka thënë Allahu – SubhaneHu ue Te'ala –:

فَإِنْ لَمْ تَفْعَلُوا فَأْذَنُوا بِحَرْبٍ مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ ۖ وَإِنْ تُبْتُمْ فَلَكُمْ زُءُوسُ أَمْوَالِكُمْ
لَا تَظْلُمُونَ وَلَا تُظْلَمُونَ

"Nëse nuk e bëni këtë, atëherë ju është shpallur luftë nga Allahu dhe i Dërguari i Tij. Nëse pendoheni (nga pasuria e fituar me kamatë), atëherë ju takon kapitali fillestar. Në këtë mënyrë, as nuk bëni padrejtësi (duke marr faide) e as nuk ju bëhet padrejtësi (që t'ju cënohet kapitali fillestar)."³⁰

²⁹ Et-Talak, 2-3.

³⁰ El-Bekarah, 279.

Ai u ka shpallur luftë njerëzve të kamatës.

"E ka mallkuar i Dërguari i Allahut – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – atë që e ha kamatën, ai që e jep atë, shkruesin e saj dhe dy dëshmitarët e saj."³¹

Çfarë do më mbas këtij mallkimi?

A të bën dobi shtëpia kur përpara vetes tënde ke Xhehenemin? Prandaj besimtari le të ketë frikë Allahun dhe të bëjë durim në fukarallëkun dhe nevojën e tij, ngase Allahu – *SubhaneHu ue Te'ala* – ka thënë:

وَلَنَبْلُوَنَّكُمْ بِشَيْءٍ مِّنَ الْخَوْفِ وَالْجُوعِ وَنَقْصٍ مِّنَ الْأَمْوَالِ وَالْأَنْفُسِ وَالثَّمَرَاتِ
وَشَرِّ الصَّبْرِ

"Padyshim që Ne do t'ju sprovojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, vetes (dhe të afërmit e tyre) si dhe të frutave, andaj përgëzoji durimtarët."³²

Duro, që të ta japë Allahu këtë shpërblim madhështor, në vend që t'i ekspozohesh mallkimit, zemërimit, pakënaqësisë dhe ndëshkimit të Tij. Përballoje këtë vështirësi në dynja, e cila nuk është gjë përpara zemërimit dhe ndëshkimit të Allahut.

Lusim Allahun që të na mjaftojë me mirësinë dhe dhuntinë e Tij nga çdo gjë që na sjell pakënaqësinë dhe zemërimin e Tij. Padyshim që Zoti ynë e dëgjon lutjen.

Lavdërimet dhe bekimet e Allahun qofshin mbi Pejgamberin tonë,

³¹ E ka transmetuar Muslimi në Sahih (11/36, nr.1598 – Neueuij – nga hadithi i Xhabirit – *radij-Allahu 'anhu*).

³² El-Bekarah, 155.

Muhamedin, si dhe mbi Familjen e tij dhe Shokët e tij.

Përktheu: Alban Malaj